



Fuqizimi i pjesëmarrjes së grave në politikë dhe vendimmarrje në Kosovë

Përmbledhje e diskutimeve në grupet punuese

Grupi 1: Përmirësimi i kuadrit ligjor

Moderatore: Mimoza Ahmetaj

Problemet e identifikuara:

- Mos harmonizimi i ligjeve, në veçanti Ligjit për Zgjedhjet dhe Ligji për Partit Politike me Ligjin për Barazi Gjinore;
- Të ndryshohet Ligji për Shërbyesit Civil;
- Të shqiptohen sanksione ndaj institucioneve të cilat nuk e zbatojnë Ligjin për Barazi Gjinore.

Rekomandimet:

- Të ndryshohen këto dy ligje pasi që ekziston mospërputhje ndërmjet tyre, psh. Ligji për Barazi Gjinore parasheh pjesëmarrjen 50% me 50% në kuvend dhe në asamble, ndërsa në Ligjin për Zgjedhjet kjo pjesëmarrje e grave garantohet 30%.
- Ligji për Shërbyesit Civil duhet të ndryshohet, sidomos sa i përket kandidimeve të grave dhe burrave në Asamblet Komunale, sepse në momentin e aplikimit ata obligohen të heqin dorë nga pozitat e tyre, e kjo po ndikon edhe në numrin më të ulët të pjesëmarrjes së grave në politikë.
- Edhe pse parashihet shqiptimi i sanksioneve penale për mos zbatim të Ligjit për Barazi Gjinore, ky ligj edhe më tutje vazhdon të shkelet. Institucionet kompetente duhet t'i ndërmarrin të gjitha veprimet dhe ndaj shkelsve të shqiptohen sanksione të cilat parashihen në këtë ligj.

Grupi 2: Puna me udhëheqësit e partive politike

Moderatore: Jeta Krasniqi

Problemet e identifikuara:

- Në përgjithësi, ka ngecje të madhe të përfaqësimit të grave;
- Zëri i gruas ndëgjohet pak në të gjitha sferat shoqërore, jo vetëm në politikë;
- Në pozitat vendimmarrëse ka më shumë burra se gra.

Rekomandimet:

- Gratë duhet të synojnë angazhim më të madh në partitë politike. Edhe vetë gratë duhet të jenë me aktive në çfardo lloj niveli, si dhe të kenë gatishmëri për bashkëpunim.
- Fuqizimi i grave dhe vajzave të mos izolohet vetëm në parti politike, por në të gjitha sferat tjera të jetës në mënyrë që të ndryshohet perceptimi i përgjithshëm për gratë në vendimmarrje. Gruas nuk i jepet hapësirë e mjaftueshme edhe pse janë shumë të zonjat.

- Gratë duhet t'i mbështesin gratë tjera në procesin elektoral. Gratë duhet të punojnë në vet-fuqizimin e grave si psh. t'i votojnë më shumë ato, të vetdijësohen që t'i japin përparësi gruas në zgjedhje më shumë se sa burrave.
- Gratë vendimmarrëse duhet t'i mentorojnë dhe udhëzojnë gratë dhe vajzat të cilat janë në fazat më të hershme të angazhimit. Gruaja si anëtare e partisë politike duhet të mirret seriozisht nga vet gruaja. Gratë duhet të fuqizohen prej nëndegëve, degëve e deri te kryesia.
- Duhet të ndryshohet stereotipi se gratë duhet të jenë "të ndëgjueshme" ndaj liderit të partisë për të pasur një pozitë në parti. Gratë duhet të synojnë fuqizimin demokratik përmes mbështetjes direkte.
- Duhet të insistohet në zbatimin integral të kuotës gjinore në të gjitha nivelet e partisë politike.
- Të rritet numri i vajzave dhe grave në trupat zgjedhore, komisionerë dhe vëzhgues.
- Avokimi për gratë në politikë nuk duhet të ndalet, duhet të vazhdojë gjatë gjithë kohës së aktivizimit politik.

(Grupi 3 dhe 7 kanë punuar së bashku)

Grupi 3: Krijimi i elektoratit dhe mobilizimi i votueseve

Moderatore: Igballe Rogova

Grupi 4: Financimi i fushatave të kandidateve

Moderatore: Adelina Berisha

Problemet e identifikuara:

- Liderët e partive nuk i përkrahin gratë.
- Buxheti partiak ndahet vetëm tek disa kandidatë (lideri dhe personat në rrethin e tij), jo tek të gjithë, shumë më pak për gratë.
- Forumet rinore janë poashtu vetëm në dispozicion të liderëve.
- I tërë buxheti i financimit të fushatave të grave është i koncentruar në të hyrat vetanake të kandidateve gra, ose përkrahja familjare.

Rekomandimet:

- Rritja e transparencës se ku shkon buxheti apo paraja e partisë, kush po përkrahet dhe rrjedhimisht ky buxhet të ndahet proporcionalisht mes kandidatëve.
- Të avokohet tek bizneset lokale dhe në nivel vendi që të përkrahen gratë gjatë fushatave.
- Shfrytëzimi i mediave sociale, të shkruara, elektronike, për promovim të grave.
- Bashkëpunim me shoqërinë civile, organizim të takimeve në komunitete për promovim të politikave që gratë kandidate kanë dëshirë t'i shtyjnë përpara.
- Zyra e BE të financiarisht gratë si dhe të monitorojnë liderët partiak për ndarje të buxheteve.

Grupi 5 dhe 6 kanë punuar së bashku

Grupi 5: Rekrutimi dhe fuqizimi i një numri më të madh grash për të garuar në zgjedhje

Moderatore: Nertila Qarri-Gerguri

Grupi 6: Adresimi i problematikave që i pengojnë gratë të marrin pjesë në politikë

Moderatore: Iliriana Banjska

Problemet e identifikuara:

- Gratë nuk e mbështesin njëra-tjetrën.
- Nuk ka mjaftueshëm qendra për kujdes për fëmijët dhe të moshuarit për të liruar gratë prej obligimeve familjare. Kjo do të mundësonte kohë për aktivizëm politik.
- Mungesa e përkrahjes së familjes, sidomos burrit.
- Gratë nga komunitetet pakicë diskriminohen dyfish.
- Gratë përjashtohen prej 'pazarllëqeve politike' që zhvillohen nga burrat (zakonisht nëpër kafene).
- Burrat nuk e kuptojnë që gratë nuk janë duke ju marrë të drejtat e tyre dhe i kundërshtojnë për këtë arsye.
- Gratë dhe vajzat nuk kanë mjaftueshëm njohuri mbi domethënien e të qenit politikisht aktiv.

Rekomandimet:

- Duhet të kalohen kufinj partiak dhe të vetëdijesohen gratë që duhet ta mbështesin njëra-tjetrën.
- Fushata të ndryshme ku gratë politike (prej të gjitha niveleve) flasin për kuptimin e aktivizimit politik.
- Të ketë sa më shumë shembuj të grave të sukseshme në politikë (role models).
- Të krijohen shkolla politike për vajza të reja.

Grupi 7: Përmirësimi i mbulimit mediatic të kandidatëve dhe politikanëve

Moderatore: Jeta Xharra

Problemet e identifikuara:

- Mos prezenca në nivelin e duhur në media të ndryshme e grave si pjesëtare të partive politike.
- Refuzimi i mediave për të ftuar gratë politike të cilat nuk janë të njohura nga publiku.
- Mungesa e diversitetit gjinor në debatet televizive.
- Mungesa e hapësirës për tu promovuar gratë politike në nivelin lokal.

Rekomandimet:

- Krijimi i databazës për media – Krijimi i një liste për media të gjithë anëtarëve të partive politike.
- Avokimi për gratë në temat e caktuara në programe të ndryshme televizive, portale etj.
- Trajnimi i grave politike për paraqitje publike nga mentorë që kanë përvojë në politikë ose profesionistë të tjerë.
- Të ju bëhet presion të gjitha partive politike që në konferencë për shtyp të shfaqin edhe gratë politike që janë të panjohura për publikun.
- Promovimi më i madh i grave politike në nivel lokal.